RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Blerina Huruglica Eksperte Shqyrtuese	20.05.2022	30.05.2022	*148/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **18.05.2022 OE"NNP Engineering",** ka parashtruar ankesë me nr.**148/22** kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Riparimet nëpër Shkollat e komunës së Vitisë",** me nr. të prokurimit: **657-22-3507-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**KUVENDI KOMUNAL VITI.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: **316 000,00 €**

Data e njoftimit për kontratë.....21.04.2022.
Hapja e ofertave.....
Data e kërkesës për rishqyrtim.....22.08.2021.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....25.08.2021.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE

Dispozitat e shkelura

AK gjate shpalljes s eketij tenderi ka bere shkelje te ketyre dispozitave ligjore.
Neni 68.
Pika 1.5
Neni 69
Pika 2.7,4.2,4.3,4.5
Neni 71
Pika 4.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ne shpalljen e tenderit nga Komuna e Vitise shihet se kriteret e vendosura ne FDT nga ana e Autoritetit Kontraktues jane ne kundershtim me LPP dhe dispozitat ligjore te tij.
Ne kerkesat 8.1&8.2 te kapacitet ekonomike dhe financiare eshte kerkuar Raporti I auditimit dhe I pasqyrave financiare per 3 vitet e fundit:Kerkojme qe ky kriter te hiqet sepse Auditimi ka kosto te larte financiare per kohen qe e kalojme ne kete krize globale dhe pandemija e ka bere te veten,apo ky kriter te zevendsohet si shumica e AK me kriterin pa kosto financiare per OE:Deklaratat Tatimore Vjetore te dorezuara ne ATK.
Kriteri ne rast te konzorciumit per 60% te qarkullimit per liderin te hiqet krejte sepse eshte diskriminues dhe nuk u jep mundesin bizneseve te reja per pjesmarrje ne Aktivetete te Prokurimit dhe ky kriter nuk aplikohet ne shumicen e AK.
NE kerkesat 9.1& 9.2 tek kapacitetet teknike dhe profesionale :
Kerkesa e AK per OE ne te ngjajshme te zevendsohet me kontrata perkatese .ndertim,riparim etj.
Kerkesa 2; Numri I punetoreve te redukohet nga 20 ne 15 punetor
Armues dhe Latues te qertifikuar te hiqet krejtesisht.
Punetor te qertifikuar nga mbrojtjane pune dhe zjarri te hiqet krejtesishte.
Lista e mjeteve te redukohet sepse eshte e tejet ngarkuar
Aneksi 6: skipi te hiqet krejtesishte
Kamion me krane te redukohet nga 2 ne 1 kamion
Kamionetat te redukohen nga 5 ne 2 cope
Skelet te hiqen krejtesisht sepse natyra epuneve eshte krejtesisht Brenda pa skele.
Kompresori I ajrit te hiqet krejtesisht (punen e tij e zevendson Hilti I zakonshem)

Prandaj Operatori Ekonomik:
Kerkojme nga OSHP ,qe lenda te kthehet ne rivendosjen e kritereve dhe gjate rivendosjes se kritereve te zbatoj dispozitat ligjore te shkelura me rastin e njoftimit per kontrate Sepse nga kriteret e vendosura shihet se eshte tendenca preferenciale per OE te caktuar per te diskriminuar OE te tjere .

KRITERET PËR VLERËSIM

/

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit me titull: **"Riparimet nëpër Shkollat e komunës së Vitisë",** me nr. të prokurimit: **657-22-3507-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**KUVENDI KOMUNAL VITI,** ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratës me datë 21.04.2022, në afat të paraparë ligjor për sqarim të dosjes së tenderit, parashtron kërkesë për rishqyrtim OE ankuesi **"NNP Engineering",** ku AK me datë 11.05.2022 publikon përgjigjen/Vendimin e cila i është aprovuar si e bazuar në disa pika lidhur me kriteret në DT.
OE ankuesi i paknaqur me vendimin, me datë 18.05.2022 parashtron ankesë në OSHP lidhur me kriteret e dosjes së tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit, krahasimit të paramasës dhe dosjes së tenderit përgjigjet si më poshtë në pretendimet e OE ankuesit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Sa i përket pretendimit të parë të OE ankues lidhur me**:**

Ne kerkesat 8.1&8.2 te kapacitet ekonomike dhe financiare eshte kerkuar Raporti I auditimit dhe I pasqyrave financiare per 3 vitet e fundit:Kerkojme qe ky kriter te hiqet sepse Auditimi ka kosto te larte financiare per kohen qe e kalojme ne kete krize globale dhe pandemija e ka bere te veten,apo ky kriter te zevendsohet si shumica e AK me kriterin pa kosto financiare per OE:Deklaratat Tatimore Vjetore te dorezuara ne ATK.

Tutje, ky pretendim i OE ankues është aprovuar nga AK, andaj hudhet poshtë për shqyrtim.

Aprovohet ankesa sipas kërkesës 8.1&8.2, kështu që largohen kërkesa për auditimin e zëvendësohet më kërkesën për pasqyrat financiare, me deklaratat tatimore të vulosura dhe të nënshkruara nga Atk.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2:

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues lidhur me:

Kriteri ne rast te konzorciumit per 60% te qarkullimit per liderin te hiqet krejte sepse eshte diskriminues dhe nuk u jep mundesin bizneseve te reja per pjesmarrje ne Aktivetete te Prokurimit dhe ky kriter nuk aplikohet ne shumicen e AK.

Tutje, lidhur me pretendimin e dytë konsideroj **se gjendet e bazuar**, për faktin se AK mund të vlerësoj ofertat edhe nëse hiqet kriteri 60% të qarkullimit për liderin.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3:

Sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues lidhur me:

NE kerkesat 9.1& 9.2 tek kapacitetet teknike dhe profesionale :
Kerkesa e AK per OE ne te ngjajshme te zevendsohet me kontrata perkatese .ndertim,riparim etj.

Tutje, ky pretendim i OE ankues është aprovuar nga AK, andaj hudhet poshtë për shqyrtim.

Kërkesa për kontrata të ngjashme gjithashtu aprovohet pasi që edhe ishte, pasi që të ngjashme nënkupton po ato që keni cekur, veç ndërtimi i vrazhdët jo.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4:

Sa i përket pretendimit të katërt të OE ankues lidhur me:

> **Kerkesa 2; Numri I punetoreve te redukohet nga 20 ne 15 punetor**

Tutje, ky pretendim i OE ankues është aprovuar nga AK, andaj hudhet poshtë për shqyrtim.

> Kërkesa për punëtor aprovohet , dhe tani ne vend të 20, duhet të jenë 15 punëtor.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5:

Sa i përket pretendimit të pestë të OE ankues lidhur me:

> **Armues dhe Latues te qertifikuar te hiqet krejtesisht.**
> **Punetor te qertifikuar nga mbrojtjane pune dhe zjarri te hiqet krejtesishte.**

Tutje, sa i përket kriterit lidhur me Armirues dhe Latues, konsideroj se mund të hiqen si kreter duke u bazuar në paramasën dhe natyrën e aktivitetit, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Kurse, sa i përket qertifikimit për mbrojtje në punë të jene të trajnuar për sigurin dhe shëndetin në pune si dhe mbrojtjen nga zjarri, konsideroj se ky kriter është i nevojshëm duke u bazuar në paramasën dhe punët të cilat do të kryhen në këtë aktivitet, dhe si e tillë **pretendimi nuk gjendet i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6:

Sa i përket pretendimit të gjashtë të OE ankues lidhur me:

Lista e mjeteve te redukohet sepse eshte e tejet ngarkuar
Aneksi 6: skipi te hiqet krejtesishte

Kamion me krane te redukohet nga 2 ne 1 kamion
Kamionetat te redukohen nga 5 ne 2 cope
Skelet te hiqen krejtesisht sepse natyra epuneve eshte krejtesisht Brenda pa skele.
Kompresori I ajrit te hiqet krejtesisht (punen e tij e zevendson Hilti I zakonshem)

Mirpo tutje, pas kërkesës për sqarim nga OE ankuesi, AK ka ka aprovuar kërkesën për disa nga kriteret, ku janë aprovuar si mëposhtë:

Sipas vlerësimit të inxhinjerëve, skelet janë të nevojshme por sipas kërkesës suaj zvogëlohet sasia nga 1000 m në 500 m. Kamionetat nga 5 (pesë) zvogëlohen në 4 (katër) e pikap nga 3 (tre) në 2 (dy)copë Siguria për shëndet dhe siguri në punë është obligative sipas Ligjit 04-L-161.

Dhe tani lista e mjeteve përbën:

Nr.	Lloji i Pajisjes	Sasia e kërkuar (copë)	Sasia që ofron ofertuesit	Të dhënat për pajisjet(viti i prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave,mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1.	Kamion kapacitet min. 10 m³	1		
2.	Skip ngarkues	1		
3.	Damper	1		
4.	Kamion vetëshkarkues me kran	2		
5.	Kamioneta	4		
6.	Pikap per puntor	2		
7.	Skele për punë ndërtimore m²	500		
8.	Kompresor ajri për thyrje betoni min 5 bar	1		

Ekspertja Shqyrtuese konsideron se, sa i përket listës së mjeteve, të vetmet ndryshime që mund të bëhen janë:

Skipi ngarkues mund të hiqet,

Si dhe kompresori i ajrit mund të zëvendësohet me hiltin e zakonshëm.

Gjerësa paisjet e tjera, konsideroj se duhet të mbeten të njetat, duke u bazuar në natyrën dhe paramasën e aktivitetit të prokurimit, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet pjesërishtë i bazuar.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE **"**NNP Engineering" të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të shtyhet afati ligjor për dorëzim të ofertave me qëllim që të bëhen ndryshimet në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Panelit Shqyrtues - **OSHP**

OE ankues - **OE"NNP Engineering"**